



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Janar 2022

Nr: 9

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E SASISË SË VULAVE REZERVË TË KOMISIONIT TË  
QENDRËS SË VOTIMIT QË DO TË PRODHOHEN PËR ZGJEDHJET E  
PJESSHME VENDORE TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së Zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 103, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 5, datë 19.02.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N:**

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”, të ndryshuar, me vendimin nr. 5, datë 19.02.2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 28.12.2020”, ka përcaktuar prodhimin e vulës rezervë me tekst unik për zëvendësimin e vulës së KQV-së apo vulës së Kryetarit të KQV-së, të nxjerrë nga përdorimi. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në vendimin e sipërcituar përcakton:

- a) numrin e vulave rezervë që do të prodhohen në rang vendi;
- b) formatin, tekstin dhe numrin serial të çdo vule rezervë.

Duke vlerësuar numrin e kufizuar të rasteve që ky material zgjedhor është përdorur në zgjedhjet pararendëse, sasia e vulave rezervë të KQV-ve në të cilat do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme vendore do të jetë në raport me numrin e QV-ve. Sasia prej 100 (një qind) vulash rezervë të KQV-ve, krijon një rezervë të mjaftueshme të këtij materiali zgjedhor për çdo ZAZ, për të përballuar çdo situatë që mund të diktojë përdorimin e vulës rezervë.



## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 103, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

## **V E N D O S I:**

1. Për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, të prodhohen 100 (njëqind) vulat rezervë të KQV-së.
2. Formatit dhe specifikimet e vulës rezervë të KQV-së janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit.
3. Teksti i vulës rezervë të KQV-së është unik për çdo vulë, dhe përbëhet nga shkronja “R” dhe një numër serial katër shifror.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022

Formati i Vulës: KQV - REZERVË



**Legjenda:**

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. tekst: Republika e Shqipërisë
4. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Komisioni i Qendrës së Votimit
6. Numri i identifikimit, tekst: REZERVË, R-0001
7. tekst: Zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022